

Pozita: Zyrtar i Ri Zyrës Mbështetëse

Departamenti: për Planifikim dhe Raportim Financiar

Divizioni: i Kontabilitetit dhe Mbështetjes

I Raporton: Udhëheqësit të Divizioni të Kontabilitetit dhe Mbështetjes

Grada: 7

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Kontrollon dhe verifikon të gjithë transferet dhe pagesat ndërkombëtare dalëse në të dy aplikacionet operative (SWIFT dhe Sistemin bazë kontabël);
- Përgatit (sipas nevojës) urdhër transferet dhe i finalizon ato në të dy aplikacionet operative (SWIFT dhe Sistemin bazë kontabël);
- Hapë, mirëmban në sistem llogaritë nostro, në sistemin bazë kontabël;
- Monitoron kalkulimin dhe likuidimin interesit në llogaritë nostro;
- Përgatit dokumentacionin e duhur për akrualet, regjistrimet kontabël të korrigjimeve, realizon regjistrimet për korrigjimet e zakonshme, për llogaritë nostro;
- Kontrollon investimet në *tregun e parasë, letrave me vlerë, afatizimet e klienteve* dhe të ngjashme;
- Menaxhon normën e këmbimit të valutave të huaja (jo euro) në sistemin kontabël (sipas nevojës);
- Menaxhon punët lidhur me transferet ndërkombëtare (hyrëse dhe dalëse)
- Zëvendëson zyrtarin e kontabilitetit në mungesë të tij/saj; dhe
- Kryen punë tjera sipas kërkesës.

Njohuritë e kërkuara:

- Diplomë universitare në Kontabilitet, Financa apo Ekonomik;
- Preferohet të ketë kualifikime profesionale në kontabilitet (si SHKAÇK, ACCA, e të ngjashme);
- Preferohet të ketë njohuri për aplikacionet e kontabilitetit (bankare), si dhe njohuri në përdorimin e Excel-it, Word-it;

Kërkesa specifike:

- Kujdes në saktësi, numra dhe analitik të detajuar.
- Aftësi të mira në komunikim.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga organizata kompetente;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura/nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **11 janar 2019**
- Aplikimi mund të bëhet on-line (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së, nr:22. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare www.bqk-kos.org
Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.